

Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut sipas nenit 91 paragrafi 3 të Ligjit për gjykata (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.58/2006 ...96/19), dhe neni 46 paragrafi 2 të Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, duke shqyrtuar sipas çështjes se shpenzimet që janë bërë për seancën e shpalljes së aktgjykimit a janë shpenzime të nevojshme sipas Ligjit për procedurë penale, për unifikimin e praktikës gjyqësore në veprimin e gjykatave të apelit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në seancën e mbajtur më 07.10.2019, miratoi siç vijon:

## M E N D I M J U R I D I K

**Shpenzimet që janë bërë për seancën e shpalljes së aktgjykimit janë shpenzime të nevojshme në kuptim të Ligjit për procedurë penale.**

## A r s y e t i m

Në lidhje me pyetjen juridike të parashtruar përgjigja rrjedh nga vet dispozitat e Ligjit për procedurë penale që kanë të bëjnë me marrjen dhe shpalljen e aktgjykimit, përkatësisht nga neni 324 dhe neni 325 të Ligjit për procedurë kontestimore.

Në fakt, në nenin 324 paragrafi 1, paragrafi 3 dhe paragrafi 4 të Ligjit për procedurë kontestimore thuhet (1) “Gjykata aktgjykimin e merr dhe shpall në emër të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë”, (3) “Aktgjykimi merret menjëherë pas përfundimit të diskutimit kryesor dhe futet në procesverbal dhe të njëjtin e publikon gjyqtari individ, përkatësisht kryetari i këshillit” dhe (4) “Në lëndët më të komplikuar gjykata mund ta shtyjë marrjen e aktvendimit për tetë ditë nga dita e përfundimit të diskutimit kryesor. Brenda këtij afati gjykata detyrimisht duhet të mbajë seancë në të cilën do ta shpallë aktgjykimin. Seancën për shpalljen e aktgjykimit gjykata detyrimisht duhet ta konvokojë në seancën në të cilën diskutimi kryesor është përfunduar dhe kjo do të mbahet pavarësisht nga ajo se palët për këtë a janë njoftuar, përkatësisht a kanë marrë pjesë në atë seancë”.

Në nenin 325 paragrafi 1 dhe paragrafi 4 nga i njëjti ligj qëndron: (1) “Kur aktgjykimi shpallet, kryetari i këshillit, përkatësisht gjyqtari individ publikisht do ta kumtojë aktgjykimin dhe shkurtimisht mund ti kumtojë shkaqet e aktgjykimit” dhe (4) “Të gjithë të pranishmit leximin e kumtimit të aktgjykimit do ta dëgjojnë duke qëndruar në këmbë”.

Nuk është kontestues rasti kur menjëherë pas përfundimit të diskutimit kryesor gjykata e shkallës së parë e merr dhe e shpallë aktgjykimin, ngase atëherë kërkohen shpenzime për diskutimin kryesor pas përfundimit të së cilës është marrë dhe shpallë aktgjykimi i shkallës së parë, shpenzime këto të cilat janë shpenzime të nevojshme në kuptim të nenit 149 të Ligjit për procedurë kontestimore dhe të cilat shqiptohen.

Kontestuese është kur gjykata në lëndë më të komplikuar mund të shtyjë marrjen e aktvendimit për 8 (tetë) ditë nga dita e përfundimit të diskutimit kryesor, ku brenda këtij afati gjykata detyrimisht duhet të mbajë seancë në të cilën do ta shpallë aktgjykimin. Kjo seancë për shpalljen e aktgjykimit siç theksohet në nenin 324 paragrafi 4 të Ligjit për procedurë

kontestimore, gjykata detyrimisht do të caktojë seancën në të cilën diskutimi kryesor është përfunduar dhe kjo do të mbahet pavarësisht nga ajo se palët për këtë a janë njoftuar, përkatësisht a kanë marrë pjesë në atë seancë.

Në kuptim të detyrimit ligjor të cituar të gjykatës për të caktuar seancë për shpalljen e aktgjykimit dhe e njëjta të mbahet, rrjedh edhe e drejta e palës, përkatësisht të autorizuesit të saj, në qoftë se merr pjesë në atë seancë të kërkojë edhe shpenzime për prezencën në të njëjtën. Kërkesën e këtillë pala, respektivisht përfaqësuesi i saj mund ta prezentojë gojarisht gjatë seancës ose me shkrim me tabelë të shpenzimeve në afat të caktuar nga gjykata sipas nenit 158 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit për procedurë kontestimore. Pas kërkesës së tillë të theksuar pastaj gjykata në kuptim të nenit 149 të Ligjit për procedurë kontestimore duhet të marrë vendim, respektivisht të njëjtën ta shqiptojë.

Sipas nenit 2 paragrafi 1 të Ligjit për avokaturë (G. zyrtare e RM nr.59/02, 60/06, 29/07, 106/08, 135/11, 113/12, 148/15), avokatura është e pavarur dhe shërbim i pavarur publik që njëkohësisht siguron dhe jep ndihmë juridike sipas këtij dhe tjetër ligji.

Sipas nenit 3 po të njëjtit ligj, ndihma juridike përbëhet në dhënien e këshillave juridike, prezentimin në udhëheqjen e negociatave dhe kryerjen e shërbimeve nga lëmi i protokolit afarist, përpilimin e dokumenteve për vepra juridike, përpilimin e marrëveshjeve për themelimin, partneritetin, bashkëpunimin dhe akteve të ngjashme lidhur me themelimin ose punën e subjekteve afariste, përpilimin e dorëzimeve gjyqësore dhe veprime tjera, përfaqësimin e palëve në gjyq, organeve shtetërore, organeve të njëjësive të vetadministrimit lokal dhe personave të tjerë juridikë e fizikë.

Avokati, sipas nenit 19 të ligjit, ka të drejtë të shpërblimit dhe kompensimit të shpenzimeve për punën e realizuar të veprimtarisë së avokatit sipas Tarifës për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e avokatëve.

Në nenin 8 paragrafi 1 pika 6 të Tarifës për shpërblimin dhe kompensimin e shpenzimeve për punën e realizuar të avokatëve (G. zyrtare e RM 13/17- teksti pastruar, nr.189/19), është paraparë se përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatave, prokurorisë publike, noterëve, përmbaruesve, qendrat për punë sociale, punëdhënësit, policët, organet e inspektoratit dhe organe të tjera, si dhe marrja përsipër e veprimeve nga pika 2 të këtij paragrafi zhvillimi i të cilave zgjat më shumë ditë, pa marrë parasysh se a janë mbajtur, kanë vazhduar ose janë shtyer, si dhe për seancën e shpalljes së Vendimit, çdo ditë e filluar konsiderohet si përfaqësim i ri, respektivisht mbrojtje e re.

Neni 6 paragrafi 1 nga Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut nënkupton se “aktgjykimi duhet të shpallet publikisht”. Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut ka marrë qëndrim se karakteri publik i procedurave para organeve gjyqësore i mbron palët në procedurat civile nga zbatimi sekret i drejtësisë pa mbikëqyrje publike ose kontrollë (*Fazlijski kundër Bullgarisë*) *Fazlijski v.Bulgaria*). nr.40908/05, § 69, 16 prill 2013). Publikimi i procedurave duke përfshirë edhe shpalljen publike të aktgjykimeve përfaqëson edhe mjet për mbajtjen e besimit në gjykatat (*Preto dhe të tjerë kundër Italisë* (*Pretto and Others v. Italy*), 8 dhjetor 1983, § 21, Series Ano.71).

Sa i përket shpalljes publike të aktgjykimeve, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut siguron garanci minimale. Ajo e vlerëson qëndrimin ndaj kërkesës procedurale nga neni 6

paragrafi 1 të Konventës se “aktgjykimi duhet të shpallet publikisht” varësisht nga rrethanat e çdo lënde konkrete, ashtu që përveç shpalljes publike të aktgjykimit do të konsiderohet se elementi i publikimit është ruajtur edhe atëherë kur janë siguruar mjete të tjera që kanë mundësuar të arrihet procedimi i duhur publik (*Mozer kundër Austrisë (Moser v.Austria)*, nr.12643/02 § 101,21 shtator 2008).

Duhet të merret parasysh se në praktikën e zbatimit të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut siguron vetëm garanci minimale sa i përket publikimit dhe shpalljes publike të aktgjykimeve në procedurat civile. Krahas saj, legjislacioni nacional nëpërmjet dispozitave relevante (neni 324 dhe 325) të Ligjit për procedurë kontestimore që e rregullojnë marrjen dhe publikimin e aktgjykimeve parasheh detyrim ligjor për shpalljen publike të aktgjykimeve, me të cilat i tejkalon standartet dhe garancitë për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit adekuat nga neni 6 paragrafi 1 i Konventës.

Nga këtu, duke u nisur nga dispozitat e cituara ligjore dhe shpjerjen e tyre në lidhje me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, si dhe qëllimin e ligjvënësit për sigurimin e publikut në procedurat, sektori konstaton se shpenzimet për seancën e shpalljes së aktgjykimit janë shpenzime të detyrueshme.

Me mendimin e tillë juridik të miratuar, Sektori i veprave civile të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, konsideron unifikimin e praktikës gjyqësore me të cilën do të përforcohet siguria juridike e qytetarëve.

**GJYKATA SUPREME  
E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT  
SEKTORI I VEPRAVE CIVILE**